



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

12627
Nr. ____ prot.

Tiranë, më 27.2018

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 95, datë 2.7.2018

**PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË “TIPOGRAFIA
USHTARAKE” SHA TIRANË.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë;

VENDOSA

1. Miratimin e statutit të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë.
2. Bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj



STATUTI I SHOQERISE
SH.A."TIPOGRAFIA USHTARAKE"

TIRANË

02/07/2018

Ne baze te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare

KREU I
EMERTIMII SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma dhe emertimi i shoqërisë

1.1 *Shoqeria* anomime e krijuar ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise formohet nga trasformimi i ish - Ndermarrjes Shteterore "Tipografia Ushtarake", Tirane, emertohet Sh.a. "Tipografi Ushtarake", Tirane

1.2 Shoqëria eshte organizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar.

1.3 Shoqëria ka stemen dhe vulen e saj

Neni 2
Selia e Shoqerise

Selia e Shoqërisë eshte ne Rr. "Qemal Stafa" Perballe porcelanit, Tirane.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Asambleja e Pergjithshme) mund te ndryshoje seline e shoqerise, mund te caktoje ose te mbylle seli dytesore ne Shqiperi dhe jashte saj, mund te hape veprimtari ose njesi te reja brenda dhe jashte vendit, si dhe te shtoje apo pakesoje objektin e shoqerise.

Neni3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise dote jete per nje afat te pacaktuar.

KREU II

Neni 4

Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Prodhim, tregtim libra artistik, rregullore, blloqe, patenta, leje qarkulfimi ne kufi, pasaporta, lic;ensa dhe Jetra me vlere, porosi shtetere dhe private, lidhje speciale regjistrash, riparim regjistrash te Gjendjes Civile, prodhim dosjesh, sistemim dokumentacioni ne arkiva etj.

Neni 5

Kapitali Themeltar – Aksionet

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 66.857.000 leke, nga kjo vlere e truallit eshte 8.857.600 leke, numri i aksioneve eshte 66,857,00 leke.

Vlera nominale e aksionit eshte 1.000 (njemije) leke secili.

Pronari i vetem i aksioneve eshte shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise.

Neni 6

Ndryshimi i kapitalit dhe transferimi i aksioneve

6.1 Ndryshimi i kapitalit te shoqerise dhe transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit, mund te behet vetem me vendim te Asamblese, ne baze te Raportit te Administratorit te Shoqerise, te hartuar ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

6.2 Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike ne rastin e nje vendimi apo urdhri te marre nga Ministri i Financave dhe Ekonomise.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË (KËSHILLI MBIKQYRËS)

KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 7

ORGANET DREJTUESE

Organet Drejtuese të shoqërisë janë :

1. Këshilli Mbikqyrës
2. Administratori

Neni 8

KËSHILLI MBIKQYRËS

- 8.1 Këshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare. Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomise .
- 8.2 Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 3 vjet. Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te gjithë te rizgjidhshem. Ata mund te shkarkohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- 8.3 Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqerisë .
- 8.4 Ne rast se nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.
- 8.5 Anetari i Keshillit Mbikqyres, i emeruar me zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e pasardhësit
- 8.6 Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se dy Keshilla Mbikqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikës se Shqiperise.
- 8.7 Anetaret e Keshillit Mbikqyres te moshes mbi 65 vjec , nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te pergjithshem ne mbyllje te ushtrimit te do viti financiar. Nese kjo perqindje tejkalohet, anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht nga detyra.

Neni 9

Kryetari dhe Nënkryetari i Këshillit Mbikqyrës

- 9.1 Këshilli Mbikqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një nënkryetar , të cilët ngarkohen të mbledhin Këshillin dhe të drejtojnë diskutimet . Ata emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen .
- 9.2 Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë një sekretare dhe jashtë anëtarëve të tij .
- 9.3 Në rast mungese të Kryetarit , mbledhjet e keshillit do të drejtohen nga Nënkryetari

Neni 10

Mbledhjet dhe Vendimet e Këshillit Mbikqyrës

- 10.1 Këshilli Mbikqyres mblidhet rregullisht te pakten nje here ne tre muaj, si dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise me kerkese te Kryetarit ose ne mungese te tij nga Nenkryetari.
- 10.2 Kryetari duhet te therrase Keshillin Mbiqyrës , brenda 15 (Pesëmbdhjete ditëve) , kur drejtori ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës i paraqitn atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim .
- 10.3 Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara me leter ose ne menyra te tjera kontakti. Por ajo mund te behet dhe me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e Keshillit Mbikqyres e pranojne ate.
- 10.4 Cdo thirrje duhet te tregojë ceshtjet kryesore te rendit te dite.
- 10.5 Mbledhja e Keshillit Mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjetër te treguar ne thirrje
- 10.6 Keshilli Mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem ne qofte se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.
- 10.7 Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te

barabarta ajo e Kryetarit eshte percaktuese.

10.8 Keshilli Mbiqeqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tijl cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

10.9 Vendimet e Keshillit Mbiqeqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi nga Kryetari i seances dhe nga nje anetar i Keshillit ose ne mungese te kryetaritl nga jo me pak se dy anetare te Keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga Kryetari Keshillit Mbiqeqyres dhe nga Administratori i shoqerise.

Neni 11 **Kopetencat e Këshillit Mbikqyrës**

Këshilli Mbikqyrës ushtron Kontroll të Vazhdueshëm për adminsitrimin e shoqërisë nga Administratori . Administratori i saj , i jep këtij të fundit autorizimin paraprak për kryerjen e operacioneve , që nuk mund të kryhen nga Administratori pa autorizim paraprak të Këshillit Mbikqyrës .

Me emërimin e Administratorëve , Këshilli Mbikqyrës lidh kontratë me ta për detyrimet që rrjedhin për administrimin e shoqërisë .

Këshilli Mbiqeqyres ka te drejte te kryeje ne do kohe verifikime dhe kontrole qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e detyres se tij.

Administratori i paraqet raport Keshillit Mbiqeqyres te paktën nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqese Keshillit Mbiqeqyres llogarite vjetore me qellim verifikimin dhe kontrollin e tyre nga ky i fundit.

Keshilli Mbiqeqyres shqyrton llogarite vjetore dhe raportin vjetor te paraqitur nga drejtori i pergjithshem dhe ja paraqit kete raport Ministrise se Financave dhe Ekonomise.

Keshilli Mbiqeqyres ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, miraton shperblimin e punonjesve te shoqerise, dhe shqyrton e miraton propozimet qe i behen nga Administratori i Shoqerise.

Keshilli Mbiqeqyres percakton vleren e kontratave per te cilen Administratori perpara se ta lidhe eshte i detyruar te marre autorizimin e Keshillit Mbiqeqyres.

Keshilli Mbiqeqyres i propozon Ministrise se Financave dhe Ekonomise lidhur me keto ceshtje :

1. Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurter , afatmesëm dhe afatgjatë të shoqërisë .
2. Kryerjen e Investimeve dhe financimeve për vitin financiarë si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë .
3. Shitjen e pasurisë që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë .
4. Si dhe për çdo çeshtje tjetër që në bazë të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” është

kopetencë e Asamblesë së Përgjithshme”

Neni 12

Shpërblimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

1. Per punen e kryer ne Keshillin Mbikeqyres, do anetar i tij, merr do muaj shperblim sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave (VKM) Nr.642, date 11.10.2005 "Per Keshillat Mbikeqyres te shoqerive shteterore".

KREU V

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 13

ADMINISTRATORI

- 13.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori i cili eshte person fizik. Numri i Administratoreve caktohet nga Aksioneri.
- 13.2 Ne vendimin e emerimit, percaktohet edhe paga e Administratorit ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.
- 13.3 Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 3 vjet. Zevendesuesi ploteson mandatin e paraardhesit. Nese nje anetar i Keshillit Mbikeqyres emerohet Administrator, mandati i tij ne Keshillin Mbikeqyres perfundon. Nje person nuk mund te jete administrator ne me shume se nje shoqeri.
- 13.4 Administratori shkarkohet nga Aksioneri vetem per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.
- 13.5 Administratori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jete ne moshen mbi 65 vjeç Administratori qe mbush 65 vjeç quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevensesohet menjehere.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrat e Administratorit

1. Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët
2. Administratori ka të gjithë fuqinë ligjore të veprjës në emër të shoqërisë ,përveç rasteve kur me ligj i ngarkohen Këshillit Mbikqyrës .
3. Aktet me të cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga administratori ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per kete akt.
4. Administratori perfaqeson ligjerisht shoqerine.
5. Administratori organizon, bashkerendon dhe drejton aktivitetin per administrimin e shoqerise.
 - Nenshkruan kontrata dhe marreveshje per te cilat eshte autorizuar nga Keshilli Mbikeqyres.
 - Pergjigjet per aktivitetin e shoqerise dhe raporton ne Keshillin Mbikeqyres per çdo tremujor.
 - Nenshkruan vendimet ne funksion të zbatimit të detyrave të caktuara për administrimin e shoqërsë .
 - Organizon punën për hartimin e projekt-programit ekonomik-financiar të shoqërisë dhe pas miratimit nga Ministri i Fianancave dhe Ekonomisë (asambleja e përgjithshme) , drejton punën për

- zbatimin e tij nga strukturat administrative të shoqërisë .
6. Administratori është përgjegjës për hartimin e planit ekonomik- financiar të shoqërisë, pasqyrimin e gjendjes financiare vjetore dhe raportimin e tij në Këshillin Mbikëqyres. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar të shoqërisë, i paraqesin me shkrim Këshillin Mbikëqyres për kontroll dhe verifikim, raportin financiar vjetor të shoqërisë të ekspertit kontabel dhe bilancin e shoqërisë.
 7. Marrëdhëniet brenda shoqërisë, funksionet dhe kriteret e vendeve të punës, përcaktohen me rregulloren e funksionimit të brendshëm të shoqërisë, e cila miratohet nga Këshilli Mbikëqyres.
 8. Administratori çdo vit i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyres strukturën organizative të shoqërisë dhe aparatit administrativ të saj.
 9. Administratori emeron dhe shkarkon punonjësit e shoqërisë në përputhje me dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet e punës.

Neni 15

Ruajtja e Sekretit

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyres, Administratorët, si dhe punonjësit e tjerë të shoqërisë, detyrohen të ruajnë sekretin edhe pas largimit nga shoqëria për të dhënat që kanë karakter të brendshëm, të cilat janë përcaktuar e miratuar nga Administratorët dhe ju janë bërë të ditura punonjësve.

KREU VI

KONTROLLI , USHTRIMI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE ,FITIMET

Neni 16

Ekspert Kontabel të Autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertet kontabel të autorizuar të cilët emerohen për një ushtrim financiar nga aksioneri i vetëm (Asambleja e Përgjithshme). Shpërblimi i tij përcaktohet me akte nënligjore.

Neni 17

Plani Ekonomik

Administratori në Përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi , udhëzimet e lëshuara nga Asambleja e Përgjithshme harton programin e zhvillimit ekonomik- financiar dhe e paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyres . Pas miratimit , programi dërgohet në Asambleenë e Përgjithshme (Ministria e Financave dhe Ekonomisë)

Neni 18

Ushtrimi Financiar , Inventari , Llogaritë vjetore

- 18.1 Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti .
 - 18.2 Administratorët , do të mbajnë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së shoqërisë , në pajtim me kërkesat ligjore .
- Në mbyllje të ushtrimit financiar , administratorët hartojnë inventarin e pasurisë , në këtë datë

dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiarë . Administratorët përgaditin gjithashtu dhe raportin e administrimit për gjëndjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiarë .

Neni 19

Rezultati i Vitit Ushtrimorë dhe Përcaktimi i Fitimit .

19.1 .Administratorët hartojnë bilancin e ushtrimit vjetorë në pajtim me kërkesat ligjore .5 % e fitimeve që rezultojnë nga bilanci I vitit ushtrimorë I miratuar sipas parashikimeve të ligjit , hiqet për të krijuar rezervën e domozdoshme .

19.2 Heqja nga fitimet për rezervën e domozdoshme nuk është e detyrueshme , kurajo arrin 1/10 e kapitalit themeltarë të shoqërisë .

19.3 Fitimi i Mbetur , shpërndalet me vendim te asamblesë së përgjithshme (Ministria e Financave dhe Ekonomisë .

Neni 20

Likuidimi dhe Prishja

20.1 Shoqëria konsiderohet e prishur , me realizimin e ngjarjeve të parashikuara në ligj , në rast prishje asambleja e përgjithshme (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) cakton 1 ose me shumë likuidatorë , duke ju dhënë atyre kopetencat përkatëse .

20.2 Me vendim te asamblesë se përgjithshme (Ministri i Financave dhe Ekonomisë), shoqëria gjithashtu mund të priset ose të bashkohet me një tjetër .

Neni 21

Asambleja E Përgjithshme

Të gjitha kopetencat e asamblesë s përgjithshme të parashikuara në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 i ndryshuar “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” , që nuk janë shprehur në këtë statut , ushtrohen nga Ministri i Financave I Financave dhe Ekonomisë , në cilësinë e aksionerit të vetëm .

Neni 22

Për cfarë nuk është shprehur në këtë statut , bëhet referimi në dispozitat e legjicacionit në fuqi dhe shoqëritë tregtare .

Miraton

ARBEN AHMETAJ

MINISTER I FINANCAVE DHE EKONOMISË

